

VENDIM
Nr. 562, datë 15.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 286, DATË 17.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘ZONA E TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK ‘TEDA TIRANË’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 286, datë 17.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ‘TEDA Tiranë’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 115 458 560 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh ...” zëvendësohet me “... 119 658 112 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh ...”;

b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. të dhënat për shpronësim të numrit rendor 41 zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. pas nënndarjes me numër rendor 64 shtohen pasuritë që shpronësohen, të paraqitura në nënndarjet me numrat rendorë nga 65 deri në 68, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

3. Ngarkohen Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK ‘TEDA TIRANË’”**

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)									Vlerësimet për shpronësim							Shënime (kufizime hipotekore barre mbi pasurinë, etj.)
													“Arë”			“Ndërtesë”			Vlera totale (lekë)	
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall	Ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	VLER A (lekë)		
41	Tahir	Ramazan	Gjokmeli	Tiranë	1867	23/17	Arë	4800	0	0.00	2	92	4,800.00	448.00	2,150,400.00	-	-	-	2,150,400.00	
65	Maniola	Shaqir	Çaushi	TIRANË	3866	116/10	Arë	4200	0	0.00	1	139	4,200.00	448.00	1,881,600.00	-	-	-	1,881,600.00	
66	Arjan Rukije Alma	Sefer Mehmet Sefer	Çaushi Çaushi Lami	TIRANË	3866	116/43	Arë	4625	0	0.00	71	191	4,625.00	448.00	2,072,000.00	-	-	-	2,072,000.00	
67	Ridvan Myzafer Trendafil Resmije Elida Enverie Flamure Vilson	Kamber Kamber Kamber Kamber Kamber Kamber Kamber	Milloshi Milloshi Petriti Karaj Ymeri Zere Milloshi	TIRANË	3866	116/38	Arë	512	0	0.00	143	173	512.00	448.00	229,376.00	-	-	-	229,376.00	
68	Ismail	Tahir	Egra	TIRANË	2105	562/11	Arë	1037	0	0.00	31	104	1,037.00	448.00	464,576.00	-	-	-	464,576.00	
VLERA TOTALE													15,174.00		6,797,952.00			-	6,797,952.00	
EFEKTI FINANCIAR													9,374.00			-			4,199,552.00	